



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 1939 Prot

Maliq më, 08.04.2024

Lënda: Dërgohet formulari për publikimin e njoftimit të formularit për pozicionin vakant

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT, TIRANË

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", prane ish Hotel Arbana

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për Organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës" i ndryshuar, të Rregullores së brëndshme "Tip" të policisë bashkiake dhe Komunës, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Maliq, bashkangjitur kësaj shkrese, dërgon për publikimin e njoftimit të pozicionit vakant Polic Bashkiak pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

1. Polic Bashkiak , Bashkia Maliq

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SHPALLJE PËR VENDE TE LIRA PUNE

POLIC BASHKIAK

Në mbështetje të nenit 139/2015 “*Per Veteqeverisjen Vendore*”, të nenit 5 të ligjit nr. 8224, date 15.05.1997 “*Per Organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës*” i ndryshuar, neni 11 të Rregullores së brendshme “*Tip*” të policisë bashkisë dhe Komunës, Bashkia Maliq shpall procedurat e konkurrimit për vënd të lire :

- 1 (nje) pozicion Polic Bashkiak në Bashkinë e Maliq

Kandidatët për kryeinspektor duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të jetë në gjendje të mire shëndetësore dhe i aftë fizikisht dhe mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të forms së prerë;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qënë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale.

Kandidatët për inspektor policie duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si mëposhtë:

- a- Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- b- Curriculum Vitae
- c- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- d- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- e- Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- f- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- g- Fotokopje e librezës së punës.
- h- Motivacioni i largimit nga puna e fundit (nëse është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
- i- Raport mjeko-ligjor;
- j- Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
- k- Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi)
- l- Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor)
- m- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave (që nuk është person fizik dhe juridik);
- n- 2 Fotografji (një copë 9 x 6 cm dhe një copë 2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo pranë sporteleve të Bashkisë Maliq brenda datës **15.04.2024**.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT

Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore në Bashkinë Maliq në datën **08.04.2024** do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Njohuri të mbi legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore;
- Njohuri të mbi ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake dhe Komunes” (i ndryshuar)
- Njohuri të mbi Rregulloren së Brendshme “Tip” të policisë bashkiake.
- Kodi i Procedurave Administrative.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

- Të sigurojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë si dhe vendimeve të Këshillit që kanë të bëjnë me sigurimin e rendit e të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike.
- Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së Bashkisë si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.
- Të mbikqyrë dhe të verifikojë nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, të zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve bashkiake.

- Të kontrollojë, bllokojë, pezullojë dhe prishë ndërtimet e paligjshme , kur vendoset nga organi përgjegjës i bashkisë. Të ndalojë zënien e paligjshme të trojeve, ndërtesave dhe objekte vetë bashkisë a të komunës si dhe të organizojë lirim të tyre.
- Të kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur zëniet, mënjanoj zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, autoparlanteve, radiove e magnet ofonëve.
- Të marrë masa për ruajtjen e rendit, kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë,ceremoni publike, artistike, fetare e sportive , në kinema, teatro, pallate e salla sportive , objekte të kultit dhe në mjedise të tjera publike.
- Të inspektojë tregjet, të kontrollojë zënien e vendeve për tregti ambulante, të verifikojë pajisjen me licencë të tregtarëve edhe personave të tjerë që merren me veprimtari shitblerjeje, me tregtimin e pijeve alkolike, objekteve me vlera artistike e kombëtare ,lëndëve djegëse, të kontrollojë respektimin e masës, peshës dhe çmimin e shitjes.
- Të kujdeset për respektimin e orarit të shërbimit të njësive tregtare, bufeve, restoranteve, bilardove, lojrave të fatit e të objekteve të tjera me veprimtari publike, si dhe për zbatimin nga ana e tyre të rregulloreve apo urdhërave të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen për përvorjen, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Kandidatet gjatë intervistës së strukturuar me shkrim dhe me gojë do të vlerësohen në lidhje me :

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 100 pike.

Vlerësimi

per dokumentacionin është 25 pike;

Vlerësimi maksimal për testimin me shkrim është 45 pike;

Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është 30 pike;

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Maliq do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendat e Bashkisë Maliq.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

Këtë Informacion do ta marrni në stendën e Bashkisë Maliq, mbas datës 22.04.2024.